



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 826/3 Prot

Tiranë, më 17.07.2019

V E N D I M

Nr.86, datë 17.07.2019

“Për plotësimin e aktit nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, për lirimin nga shërbimi civil, të nëpunësës **”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 90 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësës *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 826 prot., datë 17.05.2019 pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkesja ***** ka parashtruar pretendimin se, gjatë ristrukturimit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë, megjithëse është nëpunëse civile, Komisioni i Ristrukturimit nuk i ka ofruar asnjë pozicion tjetër në shërbimin civil, siç parashikohet në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Këshillit të Ministrave.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, ka rezultuar se, punonjësja ***** , prej disa vitesh është nëpunëse në Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë, institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, punonjësja në fjalë ka fituar statusin e nëpunësit civil në pozicionin “Specialist në sektorin e programeve të zhvillimit në

Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë” dhe pas këtij momenti marrëdhënia e saj e punësimit është trajtuar sipas legjisllacionit të shërbimit civil.

Kjo mënyrë e rregullimit të marrëdhënieve të punës, për punonjësit e drejtorive dhe zyrave arsimore në përgjithësi dhe për ankuesen në veçanti, ka vazhduar deri në momentin e riorganizimit të këtyreinstitucioneve, nëpërmjet Vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “*Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*”(DPAP), i cili e ndryshoi strukturën, organizimin, varësinë dhe natyrën e marrëdhënies së punës të punonjësve të saj.

Konkretisht, në pikën¹³ të vendimit në fjalë, përcaktohet sepas kësaj, marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), në nivel qendror e rajonal, do të rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Pas kësaj, pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve do të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit (*rregulla këto, të ndryshme nga ato të pranimit në shërbimin civil*). Ky fakt u pasqyrua edhe në urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019, të Ministrit të MASR “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*”.

Në kushtet si më sipër, kur një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil, për shkaqe të ligjshme del nga shërbimi civil, nëpunësit e tij duhet të trajtohen si në një rast ristrukturimi, sipas rregullave të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me këtë rast, pasi ka evidentuar kërkesat e gjithë pozicioneve të punës të krijuara në institucion pas riorganizimit, si në nivel qendror ashtu dhe në atë rajonal, si dhe plotësimin e kushteve nga ana e nëpunësve ekzistues, për pozicione të ndryshme të lira në sistemin e shërbimit civil, ndërmjet të tjerave, ka arritur në përfundimin se sistemimi i punonjësve ******, sipas kushteve të përcaktuara në nenet 48 e 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka qenë i pamundur prandaj me aktin nr. 5148/3 prot., datë 14.5.2019, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, duke i njohur të drejtën e shpërblimit sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në të njëjtën kohë, me aktin nr. 213, datë 15.5.2019, është vendosur emërimi i përkohshëm i nëpunëses, në pozicionin “*Specialist finance në Zyrën Arsimore Selenicë*”, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit sipas kriterëve të reja që do të vendosen, në zbatim të Vendimit nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave.

Duke analizuar veprimet si mësipër, konstatohet se Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar në përputhje me kriteret ligjore, kur ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen ******, duke urdhëruar në të njëjtën kohë trajtimin me

pagë sipas vjetërsisë në shërbimin civil, siç urdhëron pika 7, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, por në këtë akt duhej të shprehej gjithashtu edhe e drejta që i njej pika 8 e dispozitës në fjalë, sipas së cilës, nëpunësit civilë të cilët për shkak ristrukturimi/riorganizimi të institucionit dalin nga shërbimi civil, kanë të drejtë që brenda periudhës 2-vjeçare, të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të mund të konkurrojnë në procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit (pika 8 e tij), të emërohen në mënyrë të përkohshme në pozicione të shërbimit civil, etj.

Pavarësisht se kjo është një e drejtë që buron nga ligji, organi administrativ, në bazë të neneve 99 e 100, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” ka detyrimin që në aktin e tij, të shprehë qartë të gjitha të drejtat e detyrimet që përfiton apo i ngarkohen nëpunësit, në bazë të ligjit në fuqi.

Lidhur me këtë çështje, të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Departamenti i Administratës Publike në shkresën nr. 2953/1 prot., datë 24.06.2019, drejtuar ankueses dhe për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Me qëllim rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë për rastin e ankueses ***** , si dhe për rastet e tjera të ngjashme, akti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, duhet të plotësohet duke shprehur edhe të drejtën që i njihet nëpunësit prej pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 113, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si organi pjesëmarrës në kryerjen e procesit të ristrukturimit që ka nxjerrë aktin nr. 5148/3, datë 14.05.2019, për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses ***** , ta plotësojë atë me përmbajtjen e tekstit të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.

3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha